



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
FONDI I SIGURIMIT TË DETYRUESHËM  
TË KUJDESIT SHËNDETËSOR**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
SHPËRNDARËSI FARMACEUTIK**

---

**Nr. Prot.,      Datë**

**Nr. Prot.,      Datë**

## **K O N T R A T Ë**

**“PËR QARKULLIMIN E BARNAVE TË LISTËS SË BARNAVE QË  
RIMBURSOHEN NGA SHPËRNDARËSI FARMACEUTIK PËR VITIN 2018”**

**Ndërmjet**

**FONDIT TË SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR**

**Dhe**

**SHPËRNDARËSIT FARMACEUTIK \_\_\_\_\_**

Miratuar me Vendimin e Këshillit Administrativ të Fondit Nr. 5, datë 04.05.2018

Kjo Kontratë nënshkruhet në \_\_\_\_\_, në datë \_\_\_\_\_

ndërmjet:

Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, (në vijim “FONDI”) përfaqësuar nga Z/Znj. \_\_\_\_\_, Drejtor i Përgjithshëm,

dhe

Shpërndarësit Farmaceutik \_\_\_\_\_ (në vijim “Shpërndarësi”), me të dhënat e mëposhtme:

Kodi i identifikimit nga Fondi \_\_\_\_\_,

Licencë të Qendrës Kombëtare të Biznesit (në vijim QKB) nr. \_\_\_\_\_,

NIPT/NUIS nr. \_\_\_\_\_,

Adresa/Adresa sekondare e Shpërndarësit \_\_\_\_\_,

nr. telefoni \_\_\_\_\_ adresa elektronike \_\_\_\_\_,

Person fizik /ortak i vetëm/administrator/ përfaqësues ligjor, Z/Znj. \_\_\_\_\_

me drejtues teknik Z/Znj. \_\_\_\_\_ me certifikatë të Urdhrit të Farmacistëve Nr. \_\_\_\_\_.

### **Dispozita paraprake**

Duke qenë se:

A. Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (në vijim FONDI), e zhvillon aktivitetin në bazë dhe zbatim të Ligjit Nr. 10383, datë 24.02.2011, “Për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

B. Në bazë të ligjit të sipërcituar Fondi lidh kontrata me dhënësit e shërbimit shëndetësor për dhënie e shërbimeve shëndetësore të përfshira në paketat e shërbimeve ku bën pjesë Lista e barnave të rimbursuara, (në vijim LBR), e miratuar nga Këshilli i Ministrave;

C. Shpërndarësi është njësi tregtare farmaceutike që tregton me shumicë barnat e Listës së barnave të rimbursueshme në bazë të ligjit Nr. 105/2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”;

D. Shpërndarësi ka përmbushur kriteret për lidhjen e kontratave me Fondin si dhe ka paraqitur gjithë dokumentacionin e kërkuar për lidhjen e kontratave, në përputhje me Vendimin e Këshillit Administrativ të Fondit Nr. 72, datë 22.12.2015, të ndryshuar;

E. Këshilli Administrativ i Fondit ka miratuar kontratën tip “Për qarkullimin e barnave të listës së barnave që rimbursohen nga shpërndarësi farmaceutik për vitin 2018”, me VKA nr. 5, datë 04.05.2018;

palët e mësipërme bien dakord si vijon:

## **Neni 1** **Objekti i kontratës**

Objekt i kësaj kontrate është kontrolli i qarkullimit të barnave të listës së barnave që rimbursohen me çmime të miratuara nga Këshilli i Ministrave, në rrejetin e hapur farmaceutik.

## **Neni 2** **Baza ligjore**

Për hartimin dhe zbatimin e kësaj kontrate palët i referohen dhe mbështeten mbi bazën ligjore që vijon:

1. Ligji Nr. 10383, datë 24.02.2011, “Për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
2. Ligji Nr. 105/2014, datë 31.07.2014 “Për Barnat dhe Shërbimin Farmaceutik”, i ndryshuar;
3. Ligji Nr. 7975, datë 20.07.1995, “Për Barnat Narkotike dhe Lëndët Psikotrope”, i ndryshuar;
4. Ligji Nr. 7850, datë 29.7.1994, “Kodi Civil”, i ndryshuar;
5. Ligji Nr. 10279, datë 20.05.2010, “Për Kundërvajtjet Administrative”;
6. Ligji Nr. 9150, datë 30.10.2003, “Për “Urdhërin e Farmacistëve”, i ndryshuar;
7. Ligji Nr. 10081, datë 23.02.2009, “Për Licencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
8. Ligji Nr. 10107, datë 30.03.2009, “Për Kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
9. Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar;
10. Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare “ i ndryshuar;
11. Ligji Nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar;
12. Ligji Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar;
13. Ligji Nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar;
14. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 144, datë 11.02.2009, “Për miratimin e formularëve të vetëdeklarimit, për të ushtruar veprimtarinë e tregëtimit me shumicë

të barnave, të tregëtimit në farmaci dhe agjenci farmaceutike, si dhe të import-eksportit të tyre”;

15. Vendimi i Këshillit Administrativ Nr. 44, datë 14.04.2017 “Për miratimin e rregullores mbi procedurat e përshkrimit, gjenerimit, ekzekutimit, kontrollit dhe rimbursimit të recetës elektronike e-Rx”.
16. Vendimi i Këshillit Administrativ Nr. 72, datë 22.12.2015, “Për kriteret që duhet të plotësojnë Importuesit dhe Shpërndarësit farmaceutikë për lidhjen e kontratës me Fondin, dhe procedurat për lidhjen e kontratës”, të ndryshuar.

### **Neni 3**

#### **Barnat e tregtuara nga Shpërndarësi**

1. Shpërndarësi do të realizojë shitjen me shumicë të barnave që rimbursohen, të furnizuara nga importues të tjerë farmaceutik, tek Farmacitë dhe Agjencitë farmaceutike.
2. Shpërndarësi farmaceutik për barnat e rimbursueshme, të furnizohet vetëm nga Importuesit ose Shpërndarësit farmaceutik që kanë kontratë me FONDI-n, në të kundërt faturat hyrëse nuk do t’i merren në konsideratë për efekt kontrolli me inventar.
3. Shpërndarësi duhet të furnizojë farmacitë/agjencitë farmaceutike të kontraktuara me barnat e listës së barnave të rimbursueshme, në lloje/artikuj, vetëm sipas kërkesës së tyre.
4. Shpërndarësi duhet të tregtojë barnat e Listës së barnave që rimbursohen vetëm të pajisura me pullën e kontrollit të Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (në vijim AKBPM) dhe brenda serisë dhe skadencës së deklaruar.

### **Neni 4**

#### **Çmimet e tregtimit të barnave**

Shpërndarësi është i detyruar të zbatojë çmimet e barnave të listës së barnave që rimbursohen në fuqi për kohën që zgjat kjo kontratë

### **Neni 5**

#### **Ndryshimet në të dhënat ose aktivitetin e Shpërndarësit**

1. Në rastin e ndryshimit të licencës së ushtrimit të aktivitetit, drejtuesit teknik dhe ndryshimit të personit fizik/ortak i vetëm/administrator/përfaqësues ligjor të Shpërndarësit, këto ndryshime duhet t’i njoftohen me shkrim Fondit brenda 5 ditëve. Personi fizik/ortaku i vetëm/administrator/përfaqësuesi ligjor i ri i Shpërndarësit, e ushtron aktivitetin e tij brenda afatit të kontratës së mëparshme dhe mbart në vazhdimësi të gjitha të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga kjo kontratë deri në përfundim të saj.
2. Shpërndarësi ka detyrimin për të deklaruar hapjen e filialeve të reja me të njëjtin numër NIPT-i dhe adresën sekondare.
3. Shpërndarësi që ndryshon vendodhje duhet të njoftojë për këtë ndryshim FOND-in jo më vonë se 5 ditë nga data e ndryshimit.

4. Kur Shpërndarësi, ndërpret aktivitetin për më shumë se një ditë (pune) duhet të lajmërojë me shkrim ose në mënyrë elektronike, Fondin për kohën e ndërprerjes, në adresën e Email: \_\_\_\_\_.

### **Neni 6**

#### **Administrimi i dokumentacionit të Shpërndarësit**

1. Shitja e barnave të rimbursueshme nga Shpërndarësi të bëhet me faturën kompjuterike sipas kërkesave të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (ne vijim MSHMS) dhe të programit të FONDI-t, të shoqëruar me fatura tatimore me TVSH sipas standarteve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë ose fletë dalje tip të miratuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, që plotësojnë kërkesat e MSHMS, në dy kopje, ku njëra kopje merret nga marrësi dhe tjetra mbahet nga shitësi.
2. Faturat të mos jenë të plotësuara me shkrim dore.
3. Monedha e përdorur do të jetë vetëm leku shqiptar.
4. Shpërndarësi është i detyruar të mbajë në rregull dokumentacionin si më poshtë:
  - a) inventarin e gjendjes fizike të barnave të listës së barnave që rimbursohen në momentin e lidhjes së kontratës dhe në momentin e hyrjes në fuqi të listës së barnave që rimbursohen;
  - b) faturat e hyrjes së barnave të rimbursueshme;
  - c) faturat e daljes së barnave që rimbursohen sipas pikave 1, 2, 3 të mësipërme;
  - d) programin kompjuterik të hedhjes së faturave hyrje/dalje për barnat e rimbursueshme, të instaluar nga FONDI.
5. Shpërndarësi është i detyruar të ruajë dokumentacionin e pikës 4, për një periudhë kohore sipas legjislacionit në fuqi dhe t'i vërë në çdo kohë në dispozicion të Fondit për qëllime kontrolli.

### **Neni 7**

#### **Dorëzimi dhe regjistrimi i të dhënave dhe inventarëve**

1. Shpërndarësi të sjellë çdo muaj pranë FONDI-t, brenda datës 5 të muajit pasardhës informacionin në mënyrë elektronike të shoqëruar me shkresën shoqëruese, për blerjet dhe shitjet si dhe për origjinën e jashtme, sasinë, serinë, skadencën, çmimet dhe shpërndarjen nominale sipas subjekteve farmaceutike në veçanti, të barnave të listës së rimbursueshme për muajin paraardhës, sipas programit kompjuterik të instaluar nga FONDI. Ky informacion duhet të jetë i saktë.
2. Shpërndarësi dorëzon (vetëdeklaron) pranë FONDI-t inventarin e gjendjes fizike të barnave që rimbursohen, kur lidh kontratë si dhe kur hyn në fuqi lista e barnave që rimbursohen, të printuar dhe në formë elektronike si dhe inventarin e barnave të skaduara (nëse ka).

### **Neni 8**

#### **Procedurat për dorëzimin e të dhënave**

1. Në datën 1 - 5 të muajit Shpërndarësi duhet të sjellë të dhënat elektronike dhe proces verbalin përmbledhës të muajit paraardhës tek Sektori i Statistikës DIAS.

2. Shpërndarësi së bashku me databazën elektronike dorëzon dhe proces verbalin përmbledhës të firmosur dhe vulosur, të faturave hyrëse, faturave dalëse dhe inventarit sipas modelit në program me të njëjtin emër. Proces verbali ndër elementët e tjerë përmban edhe datën kur është printuar për të verifikuar se printimi i tij është bërë brenda afatit të përcaktuar.
3. Në momentin e dorëzimit tek Sektori i Statistikës, personi që merr në dorëzim të dhënat duhet të bëjë verifikimin e të dhënave nëse janë të përputhshme me dokumentin e printuar nga Shpërndarësi.
4. Nëse të dhënat përputhen, personi përgjegjës i Sektorit të Statistikës printon një kopje të proces verbalit përmbledhës dhe firmos të dyja kopjet (kopjen e sjellë nga Shpërndarësi dhe kopjen e printuar vetë). Proces-verbali i printuar në Fond, ndër elementët e tjerë, përmban edhe datën kur është printuar për të verifikuar se printimi i tij është bërë brenda afatit të përcaktuar.
5. Kopja me firmën dhe vulën e Shpërndarësit, mbahet në dosjen përkatëse të të dhënave që dorëzohen çdo muaj nga depot pranë Sektorit të Statistikës, kopja tjetër i jepet përfaqësuesit të Shpërndarësit.
6. Në rast se, konstatohen mospërputhje të të dhënave të deklaruara nga Shpërndarësi (nëpërmjet proces verbalit të sjellë) dhe ato të verifikuara nga Sektori i Statistikës, përfaqësuesit të Shpërndarësit i bëhet i njohur ky mosrakordim dhe të dhënat nuk merren në dorëzim. Shpërndarësi ka të drejtë që brenda 48 orëve të korrigjojë informacionin dhe ta ridorëzojë pranë Sektorit të Statistikës.

### **Neni 9**

#### **Krijimi i aksesit në programet dhe dokumentacionin e sigurimeve shëndetësore**

Fondi ka për detyrë të pajisë Shpërndarësin me listën e barnave që rimbursohen, me aktet nënligjore të sigurimeve shëndetësore që lidhen me veprimtarinë e Shpërndarësit si dhe me programet informatike të Fondit.

### **Neni 10**

#### **Kontrolli nga Fondi**

1. Shpërndarësi është i detyruar të pranojë kontrollin me inventarizim dhe tematik të FONDI-t, për barnat e listës së barnave që rimbursohen.
2. Shpërndarësi është i detyruar të dorëzojë me proces verbal dokumentacionin hyrje dalje kur i kërkohet për verifikim nga kontrolli i FONDI-t, dhe po me proces verbal ky dokumentacion rikthehet tek Shpërndarësi brenda afatit kohor prej 1 (një) muaji.
3. Specialistët e FONDI-t me autorizim të Drejtorit të Përgjithshëm, kanë të drejtë të ushtrojnë kontolle të gjendjes fizike dhe të dokumentacionit të barnave të listës që rimbursohen që tregtohen nga Shpërndarësi. Në çdo rast në përbërje të grupit të kontrollit duhet të ketë farmacist.
4. FONDI për kontrollin me inventar i njeh Shpërndarësit, për efekt të llogaritjeve çdo dokument ose proces verbal të lëshuar nga autoritetet kompetente lidhur me barnat e nxjerra jashtë përdorimit, të dëmtuara, të asgjësuar, etj.
5. Kur FONDI konstaton mospërputhje mes sasive të barnave që rimbursohen të qarkulluara nga Shpërndarësit sipas raportimeve të tyre, me të dhënat e rimbursimit dhe të konsumit, ka të drejtë të bëjë kontroll pranë Shpërndarësit për gjendjen fizike duke bërë inventare të këtyre barnave.

### **Neni 11**

#### **Detyrimet e Fondit lidhur me garantimin e rimbursimit të barnave të kontraktuara me Shpërndarësin**

1. FONDI merr përsipër t'ju rimburojë Farmacive/Agjencive vetëm barnat e listës së barnave që rimburohen të pajisura me pullën e kontrollit të Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore të tregtuara nga Importuesi ose/dhe Shpërndarësi që ka kontratë me FONDI-n sipas serive e skadencave që pasqyrohen në faturat e shitjes të lëshuara nga Importuesi/Shpërndarësi.
2. FONDI është i detyruar të informojë gjithë Farmacitë dhe Agjencitë farmaceutike për Shpërndarësit që kanë kontratë me FONDIN.
3. Kur nga ballafaqimi i të dhënave sipas kësaj kontrate, konstatohet se FONDI ka rimbursuar barna jashtë serive të deklaruara nga Shpërndarësi, por të sjella nga burime të pa kontraktuara nga FONDI ose barna që nuk janë objekt i kësaj kontrate, FONDI merr masa ndaj personit përgjegjës që nga gjoba, pushim nga puna dhe deri në kallëzim penal. FONDI njofton Shpërndarësit për masat e marra.

### **Neni 12**

#### **Komunikimi mes palëve**

1. FONDI dhe Shpërndarësi bien dakord të bëjnë takime të përbashkëta për të ballafaquar të dhënat që kanë të dy palët dhe për sqarimin e problemeve të lindura gjatë zbatimit të kontratës.
2. Të dy palët gjatë veprimtarisë së tyre janë të detyruar të respektojnë detyrimin e ruajtjes së konfidencialitetit të të dhënave në përputhje me kriteret e përpunimit të këtyre të dhënave sipas ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

### **Neni 13**

#### **Kushti penal**

1. Kur nga kontrolli me inventarizim i barnave të rimbursueshme tek Shpërndarësi rezultojnë diferenca në plus të pajustificuara (gjendja fizike është më e madhe se gjendja kontabël), Shpërndarësi paguan kusht penal të barabartë me 10 fishin e tepicës së konstatuar
2. Kur Shpërndarësi nuk pranon për kontroll ose shmang kontrollin pa arsye të paraqitura me shkrim, të specialistëve të FONDI-t, të cilët janë të pajisur me fletë identifikimi dhe urdhër kontrolli, ai paguan kusht penal prej 1,000,000 lekë.
3. Kur nga kontrolli rezulton se Shpërndarësi ka dërguar në FOND informacion jo të saktë, ai paguan kusht penal prej 200,000 lekë.
4. Shpërndarësi, për mosdeklarim të detyrimeve që rrjedhin nga pikat 1, 2, 3, te nenit 5 “Ndryshimet në të dhënat ose aktivitetin e Shpërndarësit”, deri në fund të muajit pasardhës, paguan kusht penal në vlerën 100,000 lekë.
5. Kur nga kontrolli i ushtruar konstatohet se në ambientet e Shpërndarësit farmaceutik mbahen barna të skaduara ( të pa veçuara nga barnat e tjerë dhe të pa shoqëruara me etiketën përkatëse me mbishkrimin të skaduara/jashtë përdorimit), Shpërndarësi farmaceutik paguan kusht penal prej 10,000 lekë për çdo seri bari.

6. Kur nga kontrolli i ushtruar konstatohet se në ambjentet e Shpërndarësit farmaceutik mbahen barna që kanë mospërputhje ndërmjet serisë së vendosur në kutinë e barit dhe serisë së vendosur në pullën e kontrollit të AKBPM (të pa shoqëruar me dokumentin përkatës justifikues), Shpërndarësi farmaceutik paguan kusht penal prej 20,000 lekë për çdo seri bari.
7. Kur Shpërndarësi nuk njofton në Fond për ndërprerjen e aktivitetit për më shumë se një ditë (pune) sipas parashikimeve të pikës 4, të nenit 5, paguan kushtin penal në vlerën 1,000,000 lekë.
8. Në raste të veçanta, të kontroleve tematike mbi deklaratimet e të dhënave në sistemet e Fondit, dhe kur konstatohet se, Shpërndarësi farmaceutik nuk ka deklaruar një faturë dalëse, ndërkohë që kjo faturë hyrëse është deklaruar nga farmacia/agjencia farmaceutike, atëherë Shpërndarësi farmaceutik do të paguajë kusht penal në vlerën prej 5 000 lekë për çdo faturë.

#### **Neni 14 Gjoha**

1. Kur nga kontrolli rezulton se Shpërndarësi ka shitur barna që nuk korrespondojnë me serinë dhe skadencën e deklaruar nga ai (nuk ka përputhje me dokumentacionin e dorëzuar të barnave), gjobitet me 50,000 lekë për çdo rast.
2. Kur nga kontrolli me inventarizim i barnave të rimbursueshme, tek Shpërndarësi rezultojnë diferenca në minus të pajustificuara (gjendja fizike është më e vogël se gjendja kontabël) me vlerë në masën e 10% të vlerës totale të shitur për barnat e inventarizuar, Shpërndarësi gjobitet me 100,000 lekë.
3. Kur nga kontrolli rezulton se Shpërndarësi ka shitur barna pa pasqyruar në fletë dalje numrin e serisë dhe skadencën, gjobitet në masën 50,000 lekë për çdo rast.
4. Për vonesa më shumë se 10 ditë nga dita e përcaktuar për sjelljen e informacionit sipas pikës 1, të nenit 7 “Dorëzimi dhe regjistrimi i të dhënave dhe inventarëve” Shpërndarësi gjobitet me 100,000 lekë.
5. Për mungesë në Shpërndarësin farmaceutik të kopje fletë dalje faturës lëshuar nga ai, Shpërndarësi gjobitet në masën 2,000 lekë për çdo faturë.
6. Procedura e konstatimit, vendosjes dhe ekzekutimit të gjobës bëhet në përputhje me ligjin “Për kundravajtjet administrative”.

#### **Neni 15 Mospranimi i dokumentacionit për efekt inventari**

1. Në rast se faturat e shitjeve nuk u përgjigjen standarteve të MSHMS dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, nuk do të merren në konsideratë nga kontrolli i FONDI-it dhe nuk do t’u njihen subjekteve farmaceutike (Shpërndarës, Farmaci, Agjenci) si të tilla.
2. Fletë daljet (faturat e shitjeve) e Shpërndarësit nuk do të merren në konsideratë për efekt kontrolli me inventar në rastet kur:
  - a) mungon vula e Shpërndarësit;
  - b) mungon firma e dhënësit (Shpërndarësit);
  - c) mungon emri i marrësit (farmacisë, shpërndarësit farmaceutik etj.);
  - d) mungon fatura tatimore;



- e) fletë dalja është plotësuar me shkrim dore;
- f) mungon kodi i barit.

### **Neni 16** **Pezullimi dhe moslidhja e kontratës**

1. Shpërndarësit për të cilin rregjistrohet ose/dhe fillon procedim penal për çështje që lidhen me zbatimin e dispozitave të kësaj kontrate, i pezullohet kontrata deri në përfundim të hetimeve nga autoritet e njohura me ligj.
2. Shpërndarësi i cili është në hetim nga organi i akuzës për çështje që lidhen me zbatimin e dispozitave të kësaj kontrate nuk gëzon të drejtën të lidhë kontratë me Fondin.
3. Nuk lidhet kontratë me Shpërndarësit të cilët janë në proces gjyqësor me FONDIN.

### **Neni 17** **Zgjidhja e kontratës**

Zgjidhja e kontratës bëhet për shkaqet e mëposhtëme:

1. Ka përfunduar afati për të cilën ajo është lidhur ose ka përfunduar afati i vlefshmërisë së Licencës së Shpërndarësit;
2. Mbyllet ose pezullohet aktiviteti me një akt të organeve kompetente;
3. Kur vërtetohen raste të daljeve fiktive të bëra nga Shpërndarësi. Në këtë rast bëhet njoftimi për ndjekje penale;
4. Kur konstatohet se nga FONDI, vazhdohet të rimburohen barna jashtë serisë, skadencës dhe sasisë të deklaruara nga Shpërndarësi;
5. Kur nga kontrolli rezulton se Shpërndarësi tregton barna që nuk janë të pajisura me pullën e kontrollit të Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, në këtë rast i propozohet edhe institucionit përkatës për heqje licence;
6. Për rast të përsëritur për tregtimin e barnave mbi çmimet e LBR të zgjidhet kontrata për një periudhë jo më pak se 1 vit;
7. Kur nga kontrolli me inventarizim i barnave të rimbursueshme, tek Shpërndarësi rezultojnë diferenca në plus të pajustificuara (gjendja fizike është më e madhe se gjendja kontabël) me vlerë në masën e 10% të vlerës totale të shitur, për barnat e inventarizuara, rast i përsëritur, Shpërndarësit i zgjidhet kontrata nga dita e njoftimit zyrtar deri në fund të periudhës së kontraktimit, por jo më pak se një periudhë 6 mujore nga koha e zgjidhjes;
8. Për deklaram të rremë Shpërndarësit i zgjidhet kontrata deri në fund të periudhës së kontraktuar por jo më pak se një periudhë 6 mujore nga koha e zgjidhjes;
9. Për vonesë më shumë se një mujore nga afati i përcaktuar në kontratë, të dërgimit (dorëzimit) të informacionit, Shpërndarësit i zgjidhet kontrata deri në fund të periudhës por jo më pak se një periudhë 6 mujore nga koha e zgjidhjes;
10. Shpërndarësit i zgjidhet kontrata, për mosdeklarim të detyrimeve që rrjedhin nga pikat 1, 2, 3, të nenit 5, “Ndryshimet në të dhënat ose aktivitetin e Shpërndarësit”, përtej afatit të parashikuar në pikën 4, të nenit 13, “Kushti penal”.

### **Neni 18**

#### **Procedura dhe pasojat e zgjidhjes së kontratës**

1. Në të gjitha rastet, zgjidhja e kontratës bëhet me njoftim zyrtar, ku përshkruhet edhe arsyeja e zgjidhjes.
2. Faturat e barnave të rimbursueshme të lëshuara nga Shpërndarësi pas datës së zgjidhjes së kontratës, nuk do t'u njihen Farmacive/Agjencive për efekt inventari dhe nuk rimbursohen nga FONDI.
3. Në rast të mbarimit të afatit të kontratës dhe mos aplikimit për rilidhje në vazhdimësi Shpërndarësi farmaceutik nuk gëzon të drejtën e lidhjes së kontratës për një periudhë 1 vjeçare.
4. Në rast zgjidhjes së kontratës përpara mbarimit të afatit nga ana e Shpërndarësit ai nuk gëzon të drejtën e lidhjes së kontratës për një periudhë 1 vjeçare.

### **Neni 19**

#### **Ankimi Administrativ**

1. Subjekti ose personi përgjegjës ndaj të cilit është vendosur një sanksion sipas parashikimeve të kësaj kontrate, ka të drejtën e ankimit pranë Komitetit të Shqyrtimit Administrativ të Fondit, brenda 10 ditëve nga marrja në dijeni e vendimit me sanksionin përkatës.
2. Ankimi administrativ duhet të përmbajë këto elemente:
  - a) subjektin që ushtron ankimin me të dhënat identifikuese dhe adresën e tij;
  - b) procedurën konkrete për të cilën paraqitet ankimi;
  - c) një përshkrim të shkurtër të shkeljes së pretenduar dhe bazën ligjore përkatëse;
  - d) pretendimin e ankuesit për vendimin përfundimtar;
  - e) provat dhe dokumentacionin përkatës të cilat kërkohen të shqyrtohen nga Komiteti.
3. Komiteti i Shqyrtimit Administrativ shqyrton brenda 30 ditëve ankimin e paraqitur në përputhje me kërkesat e pikës 2 të këtij neni por jo më vonë se afati i përfundimit të procedurës administrative.
4. Ankimi administrativ i paraqitur në përputhje me kërkesat e këtij neni, pezullon ekzekutimin e vendimit deri në vënien në dijeni të ankuesit me vendimin e Komitetit të Shqyrtimit Administrativ.
5. Kundër vendimit të Komitetit subjekti mund të ankohet në Gjykatën Administrative të Shkallës së parë.

### **Neni 20**

#### **Ndryshimet e kontratës**

1. Kjo kontratë mund të ndryshojë vetëm me shkrim dhe me vullnetin, dhe pëlqimin e të dyja palëve.
2. Çdo ndryshim, shtesë ose shfuqizim i plotë ose i pjesshëm i kësaj kontrate nuk do të ketë fuqi nëse nuk është kryer me shkrim dhe nënshkruar nga palët kontraktuese/përfaqësuesit e autorizuar të të dyja palëve.

**Neni 21**  
**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

1. Palët kontraktuese respektojnë legjislacionin shqiptar në fuqi dhe përpiqen që mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë realizimit të kontratës, t'i zgjidhin me mirëkuptim midis tyre.
2. Pala që gjykon se ekziston një mosmarrëveshje, njofton palën tjetër duke bërë një përshkrim të plotë të çështjeve që kërkojnë zgjidhje.
3. Palet kontraktuese të përfshira në mosmarrëveshje duhet të bëjnë personalisht apo nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar përpjekje për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, mbi parimin e ruajtjes së vazhdimësisë së punës.
4. Nëse palët kontraktuese apo përfaqësuesit e tyre të autorizuar nuk janë në gjendje të zgjidhin mosmarrëveshjen, brenda 14 (katërmëdhjetë) ditësh nga marrja e njoftimit apo për një kohë më të gjatë të miratuar nga palët, njëra palë njofton palën tjetër se çështja nuk është zgjidhur.
5. Për të gjitha mosmarrëveshjet që nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim, organi kompetent është Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, ku ushtron aktivitetin.

**Neni 22**  
**Hyrja në fuqi**

1. Kjo kontratë është përpiluar në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe dhe secila nga palët mban nga një kopje.
2. Kontrata pasi u lexua nga palët, u konsiderua e redaktuar sipas pëlqimit të tyre dhe u nënshkrua me vullnetin e tyre të lirë e të pavesuar.
3. Kjo kontratë hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga palët dhe i shtrin efektet e saj nga \_\_\_\_\_ deri në hyrjen në fuqi të LBR së ardhshme. Ky afat mund të ndryshojë me miratimin e përbashkët me shkrim të palëve.

Kjo kontratë firmoset nga:

Për FONDIN E SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR

..... Emri, Mbiemri dhe firma e Drejtorit të Përgjithshëm të Fondit

Për Shpërndarësin Farmaceutik \_\_\_\_\_

..... Emri, Mbiemri dhe firma e personit fizik/ortak i vetëm/administrator/përfaqësues ligjor